



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPËSTINA QESHINE
SKENDERAJ
Nr. 01-060/01-0055826/24
Data 17.12.2024



Komuna Skenderaj
Opština Sken deraj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbalit i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,
i datës 27.11.2024, ora 10:00

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Informata nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Ambientit, me Nr.06.351/01-0052104/24, i datës 13.11.2024, (Raporton drejtori i DUMA-së, **z. Driton Mulaj**);
Pika shitesë:
5. Propozimit-vendimi për miratimin e Listës rezervë së emrave për emërtim të rrugëve në Komunën e Skenderajt, me Nr.06-015/01-0053321/24, të datës 25.11.2024, (Raporton drejtori i DUMA-së, **z. Driton Mulaj**);
6. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu: I nderuar kryetar i komunës Fadil Nura, të nderuar anëtar të kuvendit, drejtor të drejtorive, dhe gjithë ju të pranishëm, shkojmë në konstatime të kuorumit, në sallë janë 26 anëtar, mungon me arsye Ragip Durmishi, Arjeta Rama, Alketa Mecini dhe Abdulla Gashi, ndërsa bashkëngjitet gjate seance Valon Musliu.

Para miratimit të rendit të ditës e kemi një pika shitesë:

-Propozimit-vendimi për miratimin e Listës rezervë së emrave për emërtim të rrugëve në Komunën e Skenderajt, me Nr.06-015/01-0053321/24, të datës 25.11.2024,

Shkojmë në votim për futjen në rend dite: Konstatojmë me (24) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, futet në rend dite Propozimit-vendimi për miratimin e Listës rezervë së emrave për emërtim të rrugëve në Komunën e Skenderajt, me Nr.06-015/01-0053321/24, të datës 25.11.2024. Shkojmë me miratimin e rendit të ditës, e hap debatin, nëse nuk ka konstatojmë me (19) vota për, (2) kundër dhe (3) abstenim, Miratohet rendi i ditës.

Vazhdojmë me piken 3 të rendit të ditës,

-Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara, e hapë debatin, nëse nuk ka shkojmë në votim; Konstatojmë me (26) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës;

-Informata nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Ambientit, me Nr.06.351/01-0052104/24, i datës 13.11.2024, (Raporton);

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj; Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Informata nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Ambientit. Informata për leje ndërtimore, që kanë qenë 36 kërkesa në shumë prej 279,279.64€, këtu nuk janë të përfshinë lejet që janë të liruar me rregullore komunale. Lista e lejeve mjedisore, kanë qenë 24 kërkesa, në shumë prej 37,923.01€, duhet cekur

që gjitha objektet të cilat kërkojnë lejet mjedisore që janë nën 450m², nuk kanë nevojë me pagua leje mjedisore sipas rregullores komunale. Dhe Informate për procesin e legalizimit, që kanë qenë 18 kërkesa, 14 janë pajisur me certifikatë të legalizimit, dhe 32 lënde janë në pronë shoqërore dhe mbesin në listë të pritjes, deri në një vendim tjetër nga ministria, dhe tri lënde janë në proces.

Kryesuesja; E hap debatin, fjalën ja kaloj:

Hysni Mehani-LVV: Fjala përshëndetëse, tash edhe pandehur, edhe drejtor, i ke të dy epitetet, ne e kemi marr vesh që është ngritur një aktakuzë kundër teje, ndoshta është mirë me tregua edhe para këshilltarëve komunal përveç së para gjykatës, se a ndjehesh fajtor për pjesën e aktakuzës, e dimë që është rasti më eklatant i mafisë të ndërtimit kur një drejtor tërhiqet sepse nuk donë me nënshkrua do leje, dhe vjen dikush tjetër i nënshkruan që janë kanë të jashtëligjshme, dhe është kthyer prapë. Po me intereson kompleksi i UÇK-së, është ndërtua U-ja, përse nuk po jepen, apo për shkak të fushatës zgjedhore apo çfarë? Dhe a ka leje për objektin të tregu që aty kanë fillua do punime, a keni leshu leje për këtë çështje?

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj; Hysni, gjitha lejet bëhen publike, dhe sipas hartës zonale, objekti i U-së nuk lidhet me këtë informatë asgjë, pranimi teknik i saj është bërë, dhe tash jemi tu u marr me procedura. Leja për objektin të tregu nuk është lëshua, operatorit ja kemi ndal punimet, sepse ja ka fillua pa lejet, dhe se shpejti i lëshohet leja.

Kryesuesja; fjalën ja kaloj:

Hysni Mehani-LVV: Drejtor, kush e lëshon pranimin teknik të U-së, a e lëshon drejtorja e urbanizmit, qysh nuk ndërlidhet me këtë informatë?

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj; Hysni, fleta parë është Informata për leje ndërtimore, Lista e lejeve mjedisore, dhe Informate për procesin e legalizimit, dhe nuk ka të bëjë këtu për pranime teknike.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (17) vota për, (10) kundër dhe (0) abstenim përkrah Informata nga Drejtorja e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Ambientit.

Vazhdojmë me pikën 5 të rendit ditës:

-Propozimit-vendimi për miratimin e Listës rezervë së emrave për emërtim të rrugëve në Komunën e Skenderajt, me Nr.06-015/01-0053321/24, të datës 25.11.2024, (Raporton);

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj; Para vetes e keni Propozimit-vendimi për miratimin e Listës rezervë së emrave për emërtim të rrugëve në Komunën e Skenderajt, në bazë Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr.17/2019 për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime listës rezervë dhe vendosjen e tyre në regjistrin komunal të adresave, neni 6 pika 1.1.4 për tu aprovuar lista rezervë e emrave nevojiten, deri 20% të numrit total të emërtimeve që është përmbush kjo listë prej 127 emrave, këtë listë e kemi dërgua në agjension për aprovim, e kemi marr aprovimin, dhe e kemi sjellë në kuvend për miratim, ndërsa riemërimi i tyre nuk mund të bëhet deri në vitin 2029 kur të hynë në fuqi ky ligj.

Kryesuesja; E hap debatin, fjalën ja kaloj:

Naser Bajraktari-IDEAL: Fjala përshëndetëse, drejtor i pash disa emra e kontestoj emrin me nr.127 Zef Kaqinari, nga Prizreni, a është gabim apo çfarë?

Fikret Rexhepi-PDK: Fjala përshëndetëse, është një kërkesë nga banoret e fshatit Izbic, konkretisht nga familjaret e dëshmorëve të fshatit Izbic, që me bërë tabela informuese të cilat tregojnë rrugën prej qytetit të Skenderajt deri të fshati Izbic të kompleksi memorial të varrezat e dëshmorëve? Edhe para 5 viteve kanë ndodhur emërtime të komplekseve memorialëve të disa fshatra nga qeverisja e kaluar, dhe familjaret janë të interesuar me ditë qysh munden me i ndryshua ata emra, sepse ata emra nuk janë as shqip, qysh shkon procedura me i ndryshua ata emra, se as nuk janë konsultua me familjaret as me banoret për emërtim?

Hysni Mehani-LVV: Drejtor, është pak e paqartë së kjo listë rezervë është çështje shumë e ndejshme, së në letër doket e thjesht, po unë di së kemi pas ankesa të vazhdueshme sepse ka konteste rreth emërimit të rrugëve, sepse dikush donë e dikush nuk donë me emërua. Kjo listë rezerve nënkupton diçka që është tu pritë deri të skadojnë, apo jemi tu fol për emërime, për rezerva me një rrugë tjetër, a mundesh me na sqarua, se nuk kemi pas kohe me i analizua ligjet për këtë propozim?

Musa Fazliu-IDEAL: Fjala përshëndetëse, po i shoh dy emra në Klinikë të poshtme, na ka ardhur si pikë shtesë ky propozim, nuk e di a mundem me pas ankesa nga qytetaret, dhe kish qenë mirë me shty për seancën tjetër këtë propozim me analizua me banoret?

Ali Lutfiu-PDK: Fjala përshëndetëse, drejtor kisha pas dëshire me pas një historik të shkurtë për këta emra, së me shume së gjysme nuk po i njoh? Edhe me herët kur kemi miratuar kësi vendime kemi kërkuar një historik të shkurtër për atë emër që me ditë a ka vdekur në luftë apo masë lufte?

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj; Kjo është listë rezervë, që i ka 127 emra, për me vendos një rrugë nese nuk e ka emrin në listë, nuk mundet me ju vendos për emërtime tjera duhet me sjellë biografën skicën sa është gjatësia e rrugës për me vendos, dhe emrat të cilat i kanë emërtime sipas UA 17/2019 nuk mundet me u ndryshua deri në vitin 2029, dhe kjo është listë rezervë nuk është emërtim të rrugëve, Naser, Zef Kaqinari veç vendlindjen e ka Prizren.

Kryesuesja; fjalën ja kaloj:

Hysni Mehani-LVV: Drejtor e kam sinqerisht, nuk e kam relacion pozitivë opozitë, po këtu ka propozime që familjaret nuk i kanë propozua nuk janë pajtua më një rrugë, dhe atë emër e qon në një rrugë tjetër, tani po hapë debate sepse propozimet kanë ardhur për rrugë konkrete, qysh e ke mendua këtë drejtor?

Floriana Halili-LVV: Fjala përshëndetëse, drejtor listën rezervë të emrave tash deri 2029 nuk keni me ndryshua këta emra, desha me pyet Nr.29 Ilmi Aliu në listë është daja jem, ma herët e keni dërgua emrin gabim Hilmi Aliu, tash familjaret me kanë thënë së keni me sjellë, tash deri me 2029 nuk keni me vendos emrin e tij për shkak të gabimit që e keni bërë?

Besnik Ahmeti-IDEAL: Fjala përshëndetëse, desha me u ndërlidh me një emër që është bërë një gabim në Kopiliq, është Shpresa Shala që duhet me qenë Arbësia Shala, nëse banë me u ndryshua?

Kryesuesja; fjalën ja kaloj:

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj; Hysni, prej kësaj liste merren emërtime të reja për me vendos emrin. Floriana emrat që kanë gabime drejtshkrimore ndreqen automatikisht dhe vendosen emrat e rregullt, po nëse ka gabime me shume së dy shkronja nuk rregullohen deri në vitin 2029 sepse nuk e lejon UA, edhe për Shpresa Shalen do te rregullojmë me Arbësia Shalen.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (25) vota për, (0) kundër dhe (1) abstenim, miratohet Propozimit-vendimi për miratimin e Listës rezervë së emrave për emërtim të rrugëve në Komunën e Skenderajt, me Nr.06-015/01-0053321/24, të datës 25.11.2024.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit ditës:

Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme, fjalën ja kaloj;

Ali Lutfiu-PDK; Krekës: Drejtorisë së Inspeksionit. Edhe pse jam në dijeni për kompetencat e komunës mbi rrugët regjionale në emër të qytetarëve kam një krekës. Kërkesë për sinjalizimin e rrugës, në Klinikë të Mesme, pikërisht tek rrethi. Në mungesë të sinjalizimit në këtë pjesë të rrugës, brenda këtij viti kanë ndodh shumë aksidente. Qytetarëve kjo ju ka kushtuar me, shëndetin e tyre. Unë e kam vlerësuar si urgjente për te ndërhyrë në këtë pjesë të rrugës. I nderuar drejtor Valon Haliti lus nga ju që të bëni presion në ministrinë përkatëse që të zgjidhet ky problem.

Lus për mirëkuptim.

Kryesuesja; fjalën ja kaloj:

Drejtor i Inspektoratit, Valon Haliti: Fjala përshëndetëse, Ali kështu do të rregullojmë këtë, fillimisht do të bëjmë një kërkesë në ministri nëse nuk e rregullojnë ata, do të rregullojmë ne përmes operatorit që e kemi të kontraktuar.

Kryesuesja: fjalën ja kaloj:

Mentor Mehmeti-PDK: Fjala përshëndetëse, pyetjet i kamë bë para së mu tërheqë ky doracak po tash po e riformulojë pyetjen, pasi në 2023 është aprovua ky doracak a keni informacione drejtor a është zbatua neper shkolla ku doracak?

Kryesuesja: fjalën ja kaloj:

Drejtori i DKA-së, Kastriot Duraku: Fjala përshëndetëse, nga muaj gusht 2023 këto doracak janë në fuqi po fatmirësisht nga mësimdhënësit tonë nuk është zbatua këta doracak, dhe nuk janë përzgjedhur si lëndë zgjedhore. Dhe kemi qenë komuna e parë që këta doracak i kemi larguar nga përdorimi, pastaj kanë vazhduar komunat tjera, dhe ne fund ka nxjerre vendim ministria për largimin e doracakeve.

Kryesuesja: Kërkoj nga sekretaria që vetëm pyetjet e Abdulla Gashit të përcillen për seancën e radhës, për arsye së mungon me arsye. Me kaq mbyllet kjo mbledhje, shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi



Kryesuesja e Kuvendit

